

Përmbledhje

Ekonomia e eurozonës, sipas të dhënave preliminare të Eurostatit, është karakterizuar me një rritje të ngadalësuar të aktivitetit ekonomik në TM1 2019 (rreth 1.2 përqind), përderisa inflacioni ka shënuar rritje të lehtë (1.4 përqind). Përkundër ngadalësimit të rritjes së aktivitetit ekonomik në eurozonë, vendet e Ballkanit Perëndimor janë karakterizuar me rritje të aktivitetit ekonomik (3.4 përqind në TM4 2018 nga 2.8 përqind në TM4 2017).

Sipas të dhënave preliminare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale në vitin 2018 shënoi rritje vjetore prej 3.9 përqind, rritje e mbështetur kryesisht nga rritja e investimeve dhe konsumit ndërsa eksportet neto ndikuan negativisht. Meqenëse të dhënat zyrtare për TM1 2019 nuk janë publikuar ende nga ASK-ja, mbështetur në tregues tjerë me frekuencë më të lartë publikimi, rritja ekonomike tremujore si dhe vjetore në TM1 2019 vlerësohet të ketë qenë më e ulët. Vlerësimet për një rritje më të ulët mbështeten në rritjen më të ngadalësuar të konsumit publik, rënies së investimeve publike, zvogëlimit të kredive të reja si dhe rritjes së importit të mallrave.

Niveli i çmimeve të konsumit në ekonominë e vendit është rritur për 3.2 përqind në TM1 2019, kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të ushqimit. Inflacioni bazë (që përjashton ushqimin, energjinë, pijet alkoolike dhe duhanin), shënoi rritje prej vetëm 0.6 përqind apo 2.6 pikë përqindje më ulët krahasuar me inflacionin e përgjithshëm.

Sektori fiskal në TM1 2019 u karakterizua me rritje të të hyrave dhe rënie të shpenzimeve buxhetore prej 10.4 përqind përkatësisht -4.5 përqind. Rrjedhimisht, si rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave dhe rënies së shpenzimeve buxhetore, buxheti i Kosovës regjistroi suficit primar buxhetor prej 6.1 milionë euro (48.6 milionë euro deficit në TM1 2018). Borxhi publik në TM1 2019 ka arritur në 1.1 miliardë euro, që është për 8.5 përqind më i lartë krahasuar me TM1 2018. Rritja e borxhit publik në Kosovë i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm përderisa borxhi i jashtëm publik u karakterizua me rënie. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 16.3 përqind nga 16.1 përqind sa ishte në TM1 2018.

Në dy muajt e parë të vitit 2019, sektori i jashtëm është karakterizuar me rritje vjetore të deficitit të llogarisë rrjedhëse për 38.2 përqind. Kjo rritje e deficitit të llogarisë rrjedhëse ishte si rezultat i rritjes së deficitit të mallrave si dhe zvogëlimit të suficitit të shërbimeve dhe të ardhurave parësore, përderisa bilanci i të ardhurave dytësore shënoi rritje. Në kuadër të bilancit të pagesave, remitencat dhe Investimet e Huaja Direkte (IHD) shënuan rritje vjetore prej 4.5 përqind përkatësisht 54.9 përqind.

PËRMBAJTJA

Përmbledhje -----	1
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor -----	4
Ekonomia e Kosovës -----	6
Sektori Real -----	6
Çmimet -----	7
Sektori Fiskal -----	9
Sektori i Jashtëm -----	9

FIGURAT DHE TABELAT


Figura 1. Zhvillimet makroekonomike në eurozonë-----	04
Figura 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë-----	06
Figura 3. Treguesit tërthortë për investimet private-----	06
Figura 4. Konsumi privat dhe burimet e financimit-----	06
Figura 5. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë-----	07
Figura 6. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë-----	08
Figura 7. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit-----	08
Figura 8. Lëvizja e çmimeve të importit-----	08
Figura 9. Lëvizja e çmimeve të prodhimit-----	08
Figura 10. Eksporti dhe importi i mallrave-----	10
Figura 11. Struktura e eksporteve sipas kategorive-----	10
Figura 12. Struktura e importeve sipas kategorive-----	10
Figura 13. Remitencat-----	11
Figura 14. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve-----	11
Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së-----	05
Tabela 2. Shkalla vjetore e inflacionit-----	05
Tabela 3. Treguesit e zgjedhur makroekonomik-----	13

SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
WEO	World Economic Outlook

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Sipas të dhënave preliminare të Agjencisë Statistikore të Bashkimit Evropian (Eurostat), në TM1 2019 ekonomia e eurozonës shënoi rritje vjetore prej 1.2 përqind, që është një normë e rritjes më e ngadalësuar krahasuar me rritjen prej 2.1 përqind në TM1 2018.



Aktiviteti i ngadalësuar ekonomik i'u atribuua zhvillimeve negative që e karakterizuan Eurozonën në vitin 2018, e që kanë të bëjnë me rritjen e proteksionizmit, rritjen e tarifave dhe pengesave të tjera tregtare, rritja e gjasave për një Brexit pa marrëveshje, zvogëlimi i prodhimit të makinave, etj. Këto zhvillime negative kanë ndikuar besueshmërinë e bizneseve dhe për rrjedhojë pritjet për ecurinë e aktivitetit ekonomik në periodat në vazhdim nuk janë edhe aq optimiste. Projektionet e Bankës Qendrore Evropiane (BQE) sugjerojnë për një rritje të

ngadalësuar ekonomike në tre vitet e ardhshme (1.7 përqind në 2019, 1.5 përqind në 2021).

Në TM1 2019, mesatarja e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në eurozonë ishte 1.4 përqind, që është nivel paksa më i lartë krahasuar me TM1 2018 (figura 1). Kontribut të rëndësishëm në rritjen e shkallës së inflacionit ka dhënë politika ekspansioniste monetare dhe masat jokonvencionale të ndërmarra nga BQE në kuadër të programit të lehtësimit sasior. Në janar 2019, Këshilli Mbikëqyrës i BQE-së vendosi t'i mbajë të pandryshuara normën e interesit të operacioneve kryesore të refinancimit (0.0 përqind), normën e interesit mbi lehtësirat kreditore (0.25 përqind) dhe depozitare (-0.40 përqind). Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës ka paralajmëruar se synon të vazhdojë riinvestimin e plotë të pagesave të principalit nga asetet që maturojnë (që janë blerë në kuadër të programit), për një periudhë të zgjatur kohe, për aq sa do të vlerësohet si e nevojshme për të siguruar kushte të favorshme të likuiditetit në treg.

Aktiviteti kreditues dhe depozitues në eurozonë ka vazhduar të rritet edhe në TM1 2019, rritje që është evidentuar si tek ndërmarrjet ashtu edhe tek ekonomitë familjare. Kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje prej 2.4 përqind ndërsa kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje prej 3.1 përqind. Në anën tjetër, depozitat në sistemin bankar janë rritur akoma më shumë dhe kanë shënuar normën e rritjes prej 5.7 përqind.

Aktiviteti ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë TM4 2018¹ ka shënuar rritje vjetore prej

¹ Të dhënat për TM1 2019 nuk janë publikuar ende, ndërsa për Bosnje e Hercegovinën nuk janë publikuar as për TM3 2018 dhe TM4 2018.

mesatarisht 3.4 përqind (2.8 përqind në TM4 2017). Mali i Zi dhe Kosova shënuan rritje më të lartë, pasuar nga Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut (tab. 1).

Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së

Përshkrimi	2017 TM1	2017 TM2	2017 TM3	2017 TM4	2018 TM1	2018 TM2	2018 TM3	2018 TM4
Bosnja dhe Hercegovina	-3.0	0.9	10.5	2.5	2.0	3.4		
Kosova	2.8	4.4	4.4	3.2	3.5	4.7	3.4	3.8
Mali i Zi	2.9	5.0	4.8	3.9	4.5	4.9	5.0	4.8
Maqedonia e Veriut	0.0	-1.3	1.5	1.0	-0.1	4.9	2.8	2.0
Serbia	1.6	1.8	2.2	2.5	4.8	4.9	4.1	3.4
Shqipëria	3.9	4.3	3.5	3.7	4.3	4.2	4.7	3.1

Burimi: Zyrat Kombëtare Statistikore të vendeve përkatëse

Me rritje të lehtë është karakterizuar edhe inflacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor, i cili në TM1 2019 ka shënuar normë mesatare prej 1.8 përqind (1.6 përqind në TM1 2018). Normat më të larta të inflacionit ishin evidente kryesisht në Kosovë dhe Serbi, ndërsa në Mal të Zi, Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut normat e inflacionit ishin më të ulëta.

Tabela 2. Shkalla vjetore e inflacionit

Përshkrimi	2017 TM1	2017 TM2	2017 TM3	2017 TM4	2018 TM1	2018 TM2	2018 TM3	2018 TM4	2019 TM1
Bosnja dhe Hercegovina	1.1	1.2	1.3	1.3	0.8	1.4	1.8	1.8	
Kosova	1.6	1.9	1.7	0.7	0.0	0.7	1.4	2.2	3.2
Mali i Zi	2.5	2.5	3.3	2.9	3.7	3.7	2.4	1.7	0.4
Maqedonia e Veriut	0.5	1.2	1.6	2.2	1.5	1.5	1.6	1.2	1.2
Serbia	3.1	3.7	3.0	2.9	1.6	1.8	2.4	2.0	2.4
Shqipëria	3.8	3.6	2.7	2.7	1.9	2.2	2.2	1.8	1.6

Burimi: Zyrat Kombëtare Statistikore të vendeve përkatëse

Sa i përket zhvillimeve në sektorin bankar, rritja e kredive dhe depozitave ishte e konsiderueshme dhe me diferenca të theksuara ndërmjet vendeve. Në TM1 2019, norma mesatare e rritjes së kredive ishte 7.2 përqind (5.6 përqind në TM1 2018). Vendet të cilat shënuan rritje më të lartë kreditimit ishin Kosova dhe Mali i Zi (11.4 përqind përkatësisht 10.2 përqind) ndërsa vendet tjera shënuan rritje më të ulët me përjashtim të Shqipërisë e cila raportoi për rënie të kreditimit prej 0.2 përqind. Depozitat shënuan normë edhe më të lartë të rritjes krahasuar me kreditë. Në TM1 2019, norma mesatare e rritjes së depozitave ishte

7.7 përqind në nivel të rajonit. Tek depozitat, norma më e lartë e rritjes është shënuar në Serbi me 10.4 përqind, pasuar nga Kosova me 10.1 përqind, Maqedonia me 9.6 përqind, Bosnja e Hercegovina me 8.5 përqind, etj.


Gjatë TM1 2019, euro është vlerësuar ndaj lirës turke për 29.1 përqind ndërsa është zhvlerësuar ndaj valutave tjera kryesore por edhe ndaj valutave të vendeve të rajonit. Ndaj dollarit amerikan është zhvlerësuar për 8.4 përqind, ndaj frankës zvicerane për 3.2 përqind, ndaj lekut shqiptar 4.8 përqind, kunës kroate 0.2 përqind dhe dinarit serb për 0.2 përqind.

Ekonomia e Kosovës

Sektori Real

Sipas të dhënave preliminare të ASK-së, BPV-ja reale gjatë vitit 2018 vlerësohet të ketë shënuar rritje prej rreth 3.9 përqind. Kontributi kryesor në rritjen ekonomike erdhi nga investimet me 4.0 pikë përqindje dhe konsumi me 3.5 pikë përqindje. Në anë tjetër, eksportet neto, si pasojë e rritjes së theksuar të importit por edhe rënies së eksportit, ndikuan negativisht në rritjen e BPV-së me -3.7 pikë përqindje (figura 2).

Figura 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë




Burimi: ASK (2019) dhe llogaritjet e BQK-së

Kontributi pozitiv i investimeve totale i atribuohet kryesisht rritjes së kredive të reja investuese prej 20.9 përqind, rritjes së shpenzimeve kapitale të qeverisë prej 13.4 përqind ndërkohë që edhe importi i mallrave kapitale shënoj rritje prej 18.2 përqind (figura 3).

Konsumi privat ka kontribuar me 3.2 pikë përqindje (-1.2 pikë përqindje në 2017). Ky kontribut pozitiv mbështetet nga zhvillimet pozitive që janë regjistruar në burimet kryesore të financimit të konsumit privat.


Figura 3. Treguesit e tërthortë për investimet private



Burimi: ASK (2019) dhe llogaritjet e BQK-së

Remitencat dhe kompensimi i punëtorëve kanë shënuar rritje vjetore prej 5.4 përkatësisht 11.0 përqind. Tregues tjetër i rritjes së konsumit privat në vitin 2018 është edhe rritja e importit të mallrave të konsumit, që shënoi rritje prej 8.9 përqind (figura 4). Përveç rritjes së konsumit privat, edhe shpenzimet rrjedhëse të qeverisë kanë shënuar rritje prej 9.2 përqind në vitin 2018.

Figura 4. Konsumi privat dhe burimet e financimit



Burimi: ASK (2019) dhe llogaritjet e BQK-së

Sipas metodës së prodhimit, kontributin më të madh në rritjen e BPV-së reale në vitin 2018 e kishin tregtia (1.1 pikë përqindje), aktivitetet financiare dhe të sigurimit (0.7 pikë përqindje) dhe ndërtimtaria (0.7

pikë përqindje) ndërsa, industria pati një kontribut negativ (0.2 pikë përqindje) në rritjen e BPV-së reale.

Edhe pse të dhënat zyrtare nga ASK-ja për BPV-në reale në TM1 2019 nuk janë publikuar ende, mbështetur në tregues tjerë me frekuencë më të lartë publikimi, BQK vlerëson se rritja ekonomike tremujore dhe vjetore gjatë këtij tremujori pritet të jetë më e ulët. Pritjet e BQK-së për rritje më të ulët kryesisht mbështeten në ndryshimin e dinamikave në sektorin fiskal gjatë fillimit të vitit (rritjes më të ngadalësuar të konsumit publik dhe rënies së investimeve publike), por edhe zvogëlimit të kredive të reja si dhe rritjes së importit të mallrave.


Sa i përket konsumit, projeksionet e BQK-së sugjerojnë një rritje më të ngadalësuar. Kredia e re për konsum shënoi rënie prej 15.7 përqind në TM1 2019, përderisa remitencat shënuan rritje prej 4.5 përqind në muajt janar dhe shkurt që është një rritje më e ngadalësuar krahasuar me rritjen prej 9.5 përqind në periudhën e njëjtët të vitit 2018. Edhe shpenzimet rrjedhëse të qeverisë të cilat shënuan rritje prej 6.0 përqind në TM1 2019 (12.0 përqind rritje në TM1 2018) sugjerojnë për ngadalësim të rritjes së konsumit publik. Në anën tjetër, është vërejtur një rritje e theksuar e importit të mallrave konsumuese prej 8.9 përqind në TM1 2019 (1.7 përqind rritje në TM1 2018). Edhe treguesit e tërthortë për investime ofrojnë sinjale jo aq pozitive në TM1 2019. Shpenzimet kapitale të qeverisë si dhe kreditë e reja për investime shënuan rënie prej 46.2 përqind përkatësisht 6.4 përqind. Në anën tjetër, IHD-të mund të kenë zbutur këto ndikime negative në rritjen e gjithsej investimeve pasi që shënuan rritje prej 54.9 përqind në dy muajt e parët të vitit 2019.

Pavarësisht zhvillimeve negative në fillim të vitit 2019, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se aktiviteti ekonomik gjatë vitit 2019 do të shënojë një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin 2018, duke arritur normën prej 4.2 përqind. Ky përmirësim i lehtë i atribuohet kryesisht pritjeve për një zvogëlim të kontributit negativ të eksporteve neto në aktivitetin ekonomik, por edhe stimulit të përforcuar fiskal dhe rritjes së remitencave dhe IHD-ve, të cilat pritet të vazhdojnë të jenë burime të qëndrueshme për financimin e aktivitetit ekonomik.

Çmimet

Indeksi i çmimeve të konsumit në TM1 2019 ka shënuar normën mesatare të rritjes prej 3.2 përqind (0.0 përqind në TM1 2018) (figura 5).

Figura 5. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2019)

Sa i përket komponentëve të IÇK-së, gjatë TM1 2019, me rritje u karakterizuan çmimet e ushqimit dhe pijeve jo-alkoolike (6.4 përqind), pasuar nga çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit (3.3 përqind) dhe çmimet e transportit (2.7 përqind), etj. Në anën tjetër, rënie e lehtë e çmimeve është shënuar tek çmimet e rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse (0.4 përqind), çmimet

rekreacionit dhe kulturës (0.5 përqind), çmimet e veshmbathjes (0.5 përqind), etj. (figura 6).


Figura 6. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2019)

Meqenëse shporta e konsumatorit kosovarë karakterizohet me pjesëmarrje shumë të lartë të produkteve me lëvizje sezonale të çmimeve (ushqim, energji, pije alkoolike dhe duhan), inflacioni bazë që përjashton këto komponente rezultoi të jetë më stabil (figura 5). Në TM1 2019, inflacioni bazë rezultoi të jetë 0.6 përqind, apo 2.6 pikë përqindje më i ulët se sa inflacioni i përgjithshëm.

Figura 7. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit




Burimi: ASK (2019)

Si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importi, dinamika e lëvizjes së çmimeve në Kosovë ndikohet në masë të madhe edhe nga lëvizja e çmimeve

të importit. Indeksi i çmimeve të importit në TM4 2018 shënoj rritje prej 3.9 përqind (figura 7).

Çmimet e produkteve minerale dhe metaleve bazë, të cilat janë kategoritë kryesore të indeksit të çmimeve të importit, shënuan rritje prej 20.7 përqind përkatësisht 2.0 përqind, ndërsa çmimet e produkteve bimore si dhe çmimet e letrës dhe artikujve të saj shënuan rënie prej 8.6 përqind përkatësisht 7.2 përqind (figura 8).


Figura 8. Lëvizja e çmimeve të importit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2019)

Indeksi i çmimeve të prodhimit në TM4 2018 u karakterizua me rritje vjetore prej 1.3 përqind.

Figura 9. Lëvizja e çmimeve të prodhimit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2019)

Rritjen më të lartë të çmimeve e shënuan prodhimi i metaleve dhe prodhimi i mobileve (4.2 përqind përkatësisht 3.9 përqind), ndërsa me rënie të çmimeve

u karakterizuan nxjerrja e xehes së metalit dhe prodhimi i lëkurës (10.3 përqind përkatësisht 1.3 përqind) (figura 9).

Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore² në TM1 2019 arritën vlerën neto prej 388.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 10.4 përqind. Sa i përket llojit të tatimeve, vërehet rritje më e lartë e të hyrave tatimore direkte të cilat arritën vlerën prej 68.2 milionë euro (9.0 përqind rritje), ndërsa të hyrat tatimore indirekte shënuan rritje prej 8.9 përqind dhe arritën vlerën prej 284.7 milionë euro. Të hyrat jo-tatimore shënuan rritje prej 11.4 përqind dhe arritën vlerën prej 45.8 milionë euro.

Ndërkaq, sa i përket shpenzimeve buxhetore³, ato arritën vlerën prej 382.5 milionë euro që paraqet një rënie vjetore prej 4.5 përqind. Kjo rënie e shpenzimeve buxhetore erdhi si pasoj e vonesave në aprovimin e Buxhetit për vitin 2019 nga ana e Kuvendit të Kosovës. Kategoria kryesore që kontribuoi në rënie e shpenzimeve buxhetore ishte ajo e shpenzimeve kapitale të cilat arritën në vetëm 43.5 milionë euro apo 46.2 përqind më pak krahasuar me TM1 2018. Kategoritë tjera të shpenzimeve buxhetore shënuan rritje. Shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje shënuan rritje prej 4.0 përqind dhe arritën vlerën prej 149.4 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale) shënuan rritje për 1.9 përqind dhe arritën vlerën prej 49.8 milionë euro. Subvencionet dhe transferet shënuan rritje për 9.8 përqind dhe arritën vlerën prej 139.7 milionë euro. Rrjedhimisht, si rezultat i rritjes

më të lartë të të hyrave dhe rënies së shpenzimeve buxhetore, buxheti i Kosovës regjistroi suficit primar buxhetor prej 6.1 milionë euro (48.6 milionë euro deficit në TM1 2018).

Borxhi publik në TM1 2019 ka arritur në 1.1 miliardë euro që është për 8.5 përqind më i lartë krahasuar me TM1 2018. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 16.3 përqind nga 16.1 përqind sa ishte në TM1 2018. Kjo rritje e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 14.5 përqind (i cili ka arritur në 701.6 milionë euro), ndërsa borxhi i jashtëm publik ka shënuar rënie prej 0.4 përqind duke arritur në 414.1 milionë euro. Pjesëmarrja e borxhit të jashtëm publik në gjithsej borxhin publik është zvogëluar në 37.1 përqind nga 40.4 përqind sa ishte në TM1 2018.

Përkundër rritjes, ky nivel i borxhit është ende larg pragut prej 40 përqind të paraparë me ligj. Për më tepër, ky nivel i borxhit publik e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit, të cilat sipas FMN-së, kanë një mesatare të borxhit publik në raport me BPV-në prej 54.3 përqind.

Sektori i Jashtëm

Në dy muajt e parë të vitit 2019, deficit i llogarisë rrjedhëse ka arritur në 93.5 milionë euro që është për 38.2 përqind më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtët të vitit 2018. Rritja e deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së deficitit të mallrave dhe zvogëlimit të bilancit pozitiv të shërbimeve dhe të


² Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

³ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave.

ardhurave parësore, ndërsa bilanci i të ardhurave dytësore shënoj rritje.

Deficiti në llogarinë e mallrave⁴ arriti vlerën prej 635.2 milionë euro në TM1 2019, që paraqet një rritje vjetore prej 9.1 përqind. Përderisa në vitin 2018 ishte shënuar rënie e eksportit të mallrave, në TM1 2019 u shënuar rritje e eksportit të mallrave dhe rritje akoma më e lartë e importit. Ky nivel i lartë i importit të mallrave rezultoi në rënie të shkallës së mbulueshmërisë së importeve me eksporte në 10.8 përqind nga 11.2 përqind në TM1 2018.

Figura 10. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro




Burimi: ASK (2019)

Në TM1 2019 eksportit i mallrave ka shënuar vlerën prej 77.1 milionë euro, që është për 5.1 përqind më shumë krahasuar me TM1 2018 (figura 10).

Rritja e eksportit të mallrave gjatë këtij tremujori ishte më e theksuar tek produktet minerale, produktet e plastikës dhe gomës si dhe makineritë dhe pajisjet elektrike. Në anën tjetër, rënie shënoj eksporti i lëkurës dhe artikujve të lëkurës, ushqimeve të përgatitura, metaleve bazë, etj. (figura 11).


Figura 11. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2019)

Vlera e importit të mallrave në TM1 2019 ishte 712.3 milionë euro, që është për 8.6 përqind më e lartë krahasuar me TM1 2018. Rritje më e lartë u shënuar tek importi i produkteve minerale, produktet e plastikës dhe gomës, importi i tekstit dhe artikujve të tekstit, etj. (figura 12).

Figura 12. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2019)


Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 55.5 milionë euro deri në shkurt 2019, një rënie prej 1.6 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Vlera e gjithsej shërbimeve të eksportuara shënoj rënie vjetore prej 3.3 përqind, duke arritur në 128.9 milionë

⁴ Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

euro, ndërsa vlera e shërbimeve të importuara shënoj rënie prej 4.6 përqind dhe arriti në 73.4 milionë euro.

Bilanci i llogarisë së të ardhurave parësore, deri në shkurt 2019, shënoj vlerën prej 11.3 milionë euro, që paraqet një rënie prej 55.1 përqind. Bilanci i të ardhurave dytësore shënoj rritje për 3.4 përqind, që i atribuohet kryesisht nivelit më të lartë të remitencave. Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore shënuan vlerën prej 113.0 milionë euro deri në shkurt 2019, apo 4.5 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtët të vitit 2018 (figura 13).

Figura 13. Remitencat, në milionë euro




Burimi: BQK (2019)

Remitencat që pranohen në Kosovë kryesisht vijnë nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 40.4 përkatësisht 21.7 përqind e gjithsej remitencave. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 6.7 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë.

Llogaria financiare deri në shkurt 2019 shënoj bilanc prej 41.8 milionë euro (11.8 milionë euro deri në shkurt 2018). Në kuadër të llogarisë financiare, hyrjet e IHD-ve në Kosovë arritën vlerën prej 44.7 milionë euro duke

shënuar rritje prej 54.9 përqind krahasuar me periudhën e njëjtët të vitit 2018.

Figura 14. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2019)

Në kuadër të strukturës së IHD-ve, kapitali dhe fondi i investimeve në aksione arriti vlerën prej 41.2 milionë euro dhe shënoj rritje prej 21.1 përqind, ndërsa IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit shënuan vlerë prej 3.4 milionë euro (-5.2 milionë euro në periudhën e njëjtët të vitit 2018) (figura 14).

Niveli më i lartë i IHD-ve u shënuar në sektorin e patundshmërisë (29.1 milionë euro), mirëpo krahasuar me periudhën e njëjtët të vitit 2018 kishte rënie për 5.7 përqind. Sektori i dytë për nga rëndësia ishte ai i shërbimeve financiare ku niveli i IHD-ve ishte 11.5 milionë euro apo 47.4 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtët të vitit 2018. Sa i përket origjinës së IHD-ve, Gjermania paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD (10.3 milionë euro), pasuar nga Zvicra me 5.6 milionë euro, SHBA-të me 4.3 milionë euro, etj.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2019): Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike nr. 26, TM1 2019, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Referencat:

BQK (2019):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <https://bqk-kos.org/?id=55>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandevë për letra me vlerë të qeverisë: <https://bqk-kos.org/?id=107>

ASK (2019):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-harmonizuar-i-cmimeve-te-konsumit-ihck-prill-2019>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-icp-tm4-2018>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-cmimeve-te-importit-icimp-tm4-2018>
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/repertori-statistikor-mbi-ndermarrjet-ekonomike-ne-kosove-tm4-2018>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-tregtise-se-jashtme-stj-mars-2019>

IMF (2019): World Economic Outlook:

<https://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2019/01/weodata/index.aspx>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	TM1 2018	TM1 2019
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)	1,298.8	-
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	0.0%	3.2%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	0.1%	3.2%
Sektori fiskal* 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	352.1	388.5
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	400.7	382.5
Bilanci primar (në milionë euro)	-48.6	6.1
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	5,905.3	6,513.1
prej të cilave: Bankat	3,872.8	4,229.1
Kredi	2,534.3	2,824.1
Depozita	3,074.0	3,383.7
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	6.8%	6.7%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.2%	1.5%
Hendeku i normës së interesit	5.6%	5.2%
Sektori i jashtëm*, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-71.9	-95.6
prej të cilave: remitencat e pranuar	108.2	113.0
Llogaria financiare	11.8	41.8
Investimet e huaj direkte në Kosovë	28.8	44.7
Investimet portfolio, net	4.3	-56.0
Investimet tjera, net	-19.0	-13.4
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-115.1	-310.9
Asetet	4,829.9	4,763.4
Detyrimet	4,944.9	5,074.4
Borxhi i jashtëm, gjithsej*	2,088.5	2,011.8
Borxhi i jashtëm privat	1,589.2	1,517.0
Borxhi i jashtëm publik	499.3	498.1

Burimi:

1/ ASK (2019), BPV për TM1 2019 nuk është publikuar ende.

2/ MF (2019).

3/ BQK (2019).

*Të dhënat për sektorin e jashtëm janë deri në shkurt 2019 ndërsa për PNI dhe borxh të jashtëm deri në dhjetor 2018.

